



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 1291/prot
2

Gramsh, më 30/05/2020

Vendim
Nr. 34, dt. 30.05.2020

Për miratimin e truallit në pronësi të bashkisë Gramsh për ndërtimin e një banese për familjen e z.Guri File Roçi banues në fshatin Lleshaj NJA Poroçan

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transportit, strehimit dhe emergjencave civile, drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe mbrojtjes së territorit Për miratimin e truallit në pronësi të bashkisë Gramsh për ndërtimin e një banese sociale për familjen e z.Guri File Roçi banues në fshatin Lleshaj NJA Poroçan”, bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, nenet 19,63, 73, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nëni 8, pika 2;

Vendosi:

- I. Të miratojë dhënien e truallit me sipërfaqe 227 m², numri i pasurisë 10/179, ish Uzina e Pilave, pa shpërblim për ndërtimin e banesës për strehimin e familjes së z.Guri File Roçi.
- II. Autorizohet kryetari i bashkisë Gramsh për lidhjen e Akt-Marrëveshjes me 3 kompanitë që do të merren me ndërtimin e banesës.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryetari i bashkisë dhe administrata e saj.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

Konc.E.Mema

Miratoi :G.Lena

Dosja nr. _____
Afati _____

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Endri MEMA



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA